

Vendim nr. 11, datë 11.02.2026

(V-11/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtare, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 03.02.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (V) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **VALENTINA KODHELI**, përfaqësuar nga avokati Artan Kodheli, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT, përfaqësuar nga Klevis Parangoni, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 797, datë 23.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2102 (205), datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2024-2102 (205), datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 49, 59/a, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 2, si dhe 141, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Valentina Kodheli (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (*IKMT*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka punuar në ish-Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (*INUK*), sot IKMT-ja, në pozicionin e inspektore, deri në lirimin nga detyra me urdhrin nr. 4541 prot., datë 15.09.2014 të kryeinspektore së INUK-ut (*urdhri i lirimit nga detyra*). Ky urdhër është nxjerrë në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (*ligji për nëpunësin civil*) dhe për zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 60, datë 13.02.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar”. Urdhri në fjalë ka përcaktuar ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës, si dhe ato financiare.

2. Duke mos qenë dakord me lirimin nga detyra, në datën 09.10.2014 kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt: (i) shfuqizimin e urdhrin të lirimit nga detyra si të paligjshëm; (ii) zgjidhjen e pasojave përmes rikthimit në detyrë dhe pagimit të pagës deri në rikthimin në detyrë, dhe bazë ligjore Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin për nëpunësin civil. Ajo ka pretenduar se statusin e nëpunësit civil e ka gëzuar bazuar në nenet 2, 4 dhe 67, pika 3 të ligjit për nëpunësin civil, përtej faktit që ky ligj është edhe baza ligjore e përdorur në urdhrin e lirimit. Në këtë kuptim, kërkuesja ka pretenduar se ligji i zbatueshëm i parashikon në mënyrë shteruese rastet se kur një nëpunës civil mund të lirohet nga detyra dhe se urdhri në fjalë është në kundërshtim flagrant me ato parashikime.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 6772, datë 24.11.2014, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, detyrimin e palës së paditur që të kthejë kërkuesen në pozicionin e mëparshëm të punës dhe detyrimin e palës së paditur, INUK-ut, t’i paguajë pagën e këtij pozicioni nga data e lirimit e në vazhdim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim INUK-u.

4. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 797, datë 23.02.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur

detyrimin e palës së paditur, INUK-ut, që t'i paguajë kërkukses në total 17.5 paga mujore, shumë e cila përfshin dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës dhe shpërblimin për vjetërsi. Ajo gjykatë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi zbatohet Kodi i Punës dhe jo ligji për nëpunësin civil, duke argumentuar gjithashtu se statusi nuk fitohet automatikisht me hyrjen në fuqi të atij ligji.

5. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur rekurs kërkuësja dhe INUK-u. Kërkuësja, në mënyrë të përmbledhur, ka ngritur si shkaqe të rekursit se gjykata e apelit ka shkelur rëndë nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), pasi ajo kryesisht ka caktuar një dëmshpërblim në bazë të Kodit të Punës, edhe pse kërkuësja nuk e ka pretenduar atë, por ka pretenduar vetëm pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagës deri në rikthimin në detyrë; pala e paditur nuk ka pretenduar në asnjë moment se kërkuësja nuk e ka gëzuar statusin e nëpunësit civil; gjykata e apelit, duke vlerësuar se kërkuësja nuk e gëzon statusin, ka keqinterpretuar ligjin për statusin e nëpunësit civil; gjykata e apelit ka arritur në konkluzionin se kërkuësja nuk e ka marrë statusin edhe pse nuk ka administruar një akt negativ nga ana e institucioneve për këtë situatë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2102 (205), datë 09.05.2024 ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe asaj të shkallës së parë, si dhe rrëzimin e padisë së kërkukses, me arsyetimin se Gjykata Administrative e Apelit e ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm, por duke dhënë shpërblime në bazë të Kodit të Punës, ka kapërcyer kufijtë e padisë, duke u shprehur tej kërtimeve të ngritura nga kërkuësja.

7. Në datën 04.04.2025 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 04.06.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 18.06.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me vendimin e datës 23.01.2026 Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën e një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

8.1. *E drejta e informimit*, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë në shkelje të detyrimeve të parashikuara në mënyrë taksative në KPC nuk i ka njoftuar vendimin e arsyetuar kërkueses.

8.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.2.1. *Së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë zbatuar gabim ligjin për nëpunësin civil kur kanë pretenduar se kërkuesja nuk e ka gëzuar statusin në atë institucion, pasi ai konsiderohet automatikisht i fituar për efekt të ligjit. Gjykata e apeli keqinterpreton dhe i referohet gabim VKM-së nr.116/2014. Ajo gjykatë, së bashku me Gjykatën e Lartë i janë shmangur thelbit të çështjes duke e devijuar atë. Njësia përgjegjëse e institucionit (Drejtoria e Burimeve Njerëzore), me anë të urdhrit për lirim nga detyra ka konstatuar se kërkuesja është nëpunëse civile, përderisa ka referuar pikërisht në atë ligj. Për më tepër që nga ana e INUK-ut nuk është paraqitur asnjë akt për refuzimin e statusit ose klasifikimin e marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës. Gjykata e Lartë është kontradiktore në qëndrimin e saj, pasi edhe pse arsyeton se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, ajo nuk ka vlerësuar nëse ka shkelje nga ana e INUK-ut. Ajo nuk është shprehur për pretendimin kushtetues lidhur me të drejtën për punë dhe barazinë përpara ligjit, duke gjykuar me dy standarde dhe me njëanshmëri të plotë, dhe në shkelje të nenit 1 të KPC-së. Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë, mirëpo Gjykata e Lartë nuk ka analizuar thelbin e pretendimit, se ndërprerja e marrëdhënies së punës është e paligjshme. Në këtë rast gjykata duhet ta zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë ose të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

8.2.2. *Së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë, në kuadër të detyrimeve të neneve 14, 17 dhe 24 të KPC-së, duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë

gjqësore me praninë e palëve, pasi asnjëra nga palët në gjykim nuk ka ngritur më parë në rekurs ndonjë nga pretendimet që arsyeton Gjykata e Lartë për themelin e shkakut të padisë.

8.3. *E drejta për punë dhe barazi përpara ligjit*, e garantuara nga nenet 18, 49 dhe 59, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, pasi veprimet e kryeinspektorit të INUK-ut, të cilat cenojnë të drejtën themelore të punës dhe barazinë e shtetasve përpara ligjit, janë krejtësisht të pabazuara në nenin 66 të ligjit për nëpunësin civil, i cili urdhëron se largimi nga shërbimi civil bëhet vetëm kur ekzistojnë rrethanat e përcaktuara në të.

9. ***Subjekti i interesuar, IKMT-ja***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u informuar është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka pasur korrespondenca të vazhdueshme me kërkuesen, ku i ka bërë me dije asaj publikimin e vendimit në faqen elektronike të gjykatës.

9.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi:

9.2.1. Kërkuesja nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, sepse nuk ka asnjë vendim të Departamentit të Administratës Publike (DAP) ose të njësisë përgjegjëse pranë IKMT-së që e konfirmon atë si nëpunëse publike.

9.2.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë dhe në përmbushje të *standardit të arsyetimit*, ndërsa gjykata e apelit nuk e ka zgjidhur drejt çështjen duke i zgjidhur pasojat e mosmarrëveshjes në bazë të Kodit të Punës.

9.2.3. Kërkueses i është garantuar *e drejta për t’u mbrojtur dhe për t’u dëgjuar* nga Gjykata e Lartë, pasi ajo i ka paraqitur të gjitha kundërshtimet e saj me anë të rekursit të paraqitur në atë gjykatë dhe, në këtë këndvështrim, shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk përbën shkelje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të

drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Gjykata vëren se kërkesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjete të tjera juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 09.05.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në datën 04.04.2025. Ndërkohë nga të dhënat e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se kërkesja është informuar për vendimin nga Gjykata e Lartë me shkresën e datës 24.02.2025. Duke iu referuar kësaj date si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, rezulton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, rrjedhimisht kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

14. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u informuar, së drejtës për proces të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit* dhe së drejtës për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar) dhe së drejtës për punë e barazi përpara ligjit.

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u informuar, kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar asaj vendimin e arsyetuar. Gjykata thekson se, siç është pohuar në jurisprudencën e saj (*shih vendimin nr. 7, datë 20.02.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), ky lloj argumenti nuk lidhet me të drejtën e informimit sipas nenit 23 të Kushtetutës, por me të drejtën e njoftimit të vendimit gjyqësor gjatë një procesi të rregullt ligjor të garantuar

nga neni 42 i Kushtetutës. Në këtë këndvështrim, Gjykata konstaton se kërkesja ka marrë njoftim pas disa kërkesave të saj për vendimin e Gjykatës së Lartë dhe nuk është penguar për të paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë për ta kundërshtuar atë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

16. Kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për *proces të rregullt ligjor* në aspektin e *së drejtës për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar*, duke parashtruar se Gjykata e Lartë ka arsyetuar për çështje të cilat nuk janë ngritur si pretendime nga palët në rekursin e tyre. Në këto kushte, sipas saj, ajo gjykatë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve për të dëgjuar pretendimet e tyre.

17. E drejta e mbrojtjes dhe ajo për t'u dëgjuar, si elemente, të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohej realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023; nr. 7, datë 12.03.2010; nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka vënë dukje se kur Gjykata e Lartë merr në shqyrtim çështje ligjore që nuk janë paraqitur si shkaqe në recurs, duke i verifikuar ato me nismën e saj, ajo duhet që paraprakisht t'u japë mundësi palëve ndërgjyqëse të paraqesin mendimet e tyre, me qëllim garantimin e së drejtës për t'u mbrojtur efektivisht për to dhe disponimin e një vendimi gjyqësor, që u jep përgjigje përfundimtare pretendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i përket procedurës së shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, ligjvënësi ka parashikuar disa kërkesa specifike në nenin 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, i cili është i zbatueshëm në gjykimin administrativ, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas kësaj dispozite, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit (pika 2).

19. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkesja, e cila ka pretenduar paligjshmërinë e urdhrit të lirimit dhe zgjidhjen e pasojave përmes rikthimit në detyrë dhe pagimit të pagës deri në rikthimin në detyrë. Gjykata e shkallës së parë e

ka pranuar kërkesëpadinë e kërkueses duke vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, detyrimin e palës së paditur që të kthejë kërkuesen në pozicionin e mëparshëm të punës dhe detyrimin e palës së paditur, INUK-ut, t'i paguajë asaj pagën e këtij pozicioni nga data e lirimit e në vazhdim. Ky vendim është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm ishte Kodi i Punës dhe i ka zgjidhur pasojat e paligjshmërisë së aktit të lirimit në bazë të tij, duke dëshmshpërblyer kërkuesen me disa paga. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuësja dhe INUK-u, ndërkohë që kërkuësja, në mënyrë të përmbledhur, ka ngritur si shkaqe të rekursit se gjykata e apelit ka shkelur rëndë nenin 6 të KPC-së, pasi ajo kryesisht ka caktuar një dëshmshpërblim në bazë të Kodit të Punës, edhe pse kërkuësja nuk e ka pretenduar atë, por ka pretenduar vetëm pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagës deri në rikthimin në detyrë. Ndërsa INUK, në mënyrë të përmbledhur, ka ngritur si shkaqe të rekursit se kërkuësja është larguar nga detyra me motivacionin e ristrukturimit të institucionit në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe se vonesat e DAP-it për konfirmimin e saj si nëpunës civil nuk mund të përdoren si justifikim nga gjykata e apelit për të trajtuar largimin nga detyra të kërkueses sipas dispozitave të Kodit të Punës. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka evidentuar se përpara tij nuk janë parashtruar për shqyrtim çështje ligjore të panjohura për palët ndërgjyqëse, përkundrazi ato kanë qenë pjesë integrale e debatit gjyqësor midis tyre, referuar përmbajtjes së akteve procedurale.

20. Nisur nga sa më lart, Gjykata vëren thelbi i këtij pretendimi të kërkueses ka të bëjë me faktin se gjykata e apelit është shprehur në tejkallim të objektit të padisë, duke i dhënë kërkueses dëshmshpërblim për shkak të lirimit nga detyra, të pakërkuar prej saj. Ndërkohë Gjykata konstaton se objekti i padisë së ngritur në procesin gjyqësor nga kërkuësja lidhej me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagës deri në rikthimin në detyrë, objekt i cili në thelb ka të bëjë me zgjidhjen e pasojave nga lirimi nga detyra. Në këtë kuptim, nisur edhe nga shkaqet e ngritura në rekurs nga palët ndërgjyqëse, Gjykata vëren se palët në proces kanë pasur mundësinë të shprehen në lidhje me zgjidhjen e pasojave/akordimin e dëshmshpërblimit nga gjykata e apelit sipas Kodit të Punës, çka do të thotë se kjo çështje ka qenë pjesë e debatit gjyqësor.

21. Bazuar në këtë analizë, Gjykata çmon se nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë verifikuar çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, mbi këto argumente, është haptazi i pabazuar.

22. Për pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuësja nuk ka paraqitur asnjë argument në mbështetje të tij, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa pretendimin për cenimin e së *drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të garantuar në nenin 49, pika 1, të Kushtetutës, kërkuësja, në thelb, e lidh me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e çështjes së saj. Në jurisprudencën e Gjykatës, e drejta e çdo individi për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. (*shih vendimet nr. 32, datë 27.10.2021; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nisur nga fakti se neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor, si dhe bazuar në argumentet e paraqitura nga kërkuësja, vlerëson ta analizojë këtë pretendim në vijim në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për gjithçka që kërkohej prej saj, pasi ka lënë pa analizë thelbin e pretendimit se ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ish-punëdhënësi është e paligjshme.

24. Subjekti i interesuar, IKMT-ja, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë dhe në përmbushje të standardit të arsytimit, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit që ka zgjidhur pasojat e mosmarrëveshjes në bazë të Kodit të Punës, është i padrejtë.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen,

pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrар, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se në rastet kur pretendohet se vendimet gjyqësore objekt kontrolli përmbajnë elementë arbitrariteti, nuk vihet në dyshim e drejta e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë. Megjithatë duke pasur si pikënisje të drejtën e kërkuarit për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element përbërës i së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe duke u kujdesur që në asnjë rast gjykimi kushtetues të mos marrë trajtën e një gjykimi të zakonshëm të shkallës së katërt, për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të këtij lloji, Gjykata kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore e faktike të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit (që mbeten për t'u zgjidhur në sferën e gjykimit të gjykatave të zakonshme), por që gjithsesi cenojnë të drejtën e kërkuarit për të pasur një gjykim të drejtë.

28. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e argumenteve të kërkuarës dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata do të analizojë në vijim nëse kërkuarja ka marrë përgjigje përfundimtare për thelbin e pretendimit të saj për paligjshmërinë e lirit nga detyra, duke shqyrtuar nëse vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesëpadisë së saj është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit ose nëse përmban elemente arbitrariteti, në kuptim të gabimeve të dukshme, nga pikëpamja ligjore.

29. Konkretisht, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e urdhrit të lirimit nga detyra, si të paligjshëm, dhe zgjidhjen e pasojave, përmes rikthimit në detyrë dhe pagimit të pagës deri në rikthimin në detyrë. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesëpadinë e kërkueses duke vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, detyrimin e palës së paditur që të kthejë kërkuesen në pozicionin e mëparshëm të punës dhe t'i paguajë asaj pagën e këtij pozicioni nga data e lirimit e në vazhdim, pra rregullimin e pasojave sipas ligjit për nëpunësin civil. Sipas asaj gjykate, lirimi nga detyra është bërë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pozicioni i punës së kërkueses përfshihej në kategorinë e nëpunësit civil. Në vijim, ajo ka vlerësuar se akti administrativ në fjalë është absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore, duke qenë se në bazë të ligjit është komisioni disiplinor autoriteti publik që vendos për dhënien e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, dhe jo kryeinspektori i INUK-ut. Për më tepër, ajo gjykatë ka arsyetuar se kjo masë mund të jepet vetëm për shkelje shumë të rënda dhe të përcaktuara në nenin 57 të ligjit të zbatueshëm, ndërsa në rastin konkret, INUK-u nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ dhe as shkeljet e rënda me faj të kërkueses, që mund të përbënin shkak për marrjen e kësaj mase.

30. Ky vendim është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka çmuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi zbatohet Kodi i Punës dhe jo ligji për nëpunësin civil, me arsyetimin se ndonëse pozicioni i punës së kërkueses përfshihej në kategorinë e nëpunësit civil, ajo nuk e ka gëzuar këtë status, për shkak se nuk është rekrutuar sipas procedurës konkurruese të përcaktuar në ligj dhe në VKM-në nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit për nëpunësin civil. Në vijim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, ajo ka vlerësuar se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar nga ish-punëdhënësi, për pasojë i ka caktuar kërkueses masën e dëmshpërblimit sipas nenit 155 të Kodit të Punës, duke arsyetuar se kjo masë është lënë në diskrecion të saj.

31. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë në tërësinë e saj, me arsyetimin se, ndonëse gjykata e apelit e ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm, ajo e ka zgjidhur mosmarrëveshjen bazuar në një shkak tjetër ligjor, të papretenduar dhe të pakërkuar nga ana e kërkueses. Sipas atij kolegji, në bazë të nenit 6 të KPC-së, gjykata duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet dhe se moszbatimi i këtij parimi nga gjykata e apelit është ngritur si shkak rekursi nga kërkuesja, duke i qëndruar pretendimit se ajo gëzon statusin e nëpunësit civil. Ai kolegji ka

vlerësuar se gjykata e apelit nuk mund të shprehej tej kërkimeve në padi dhe ankim, pasi mënyra e të vepruarit *ultra petita partium*, pa pasur autorizim të shprehur ligjor, nuk lejon që gjykata të përmbushë rolin e saj si arbitër i paanshëm, për shkak se krijohen premisa për pamundësi objektive për mbrojtje ligjore në gjykim për palën tjetër. Në këtë kuptim, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se gjykata nuk mund të caktojë vetë se cilat dëmshpërblime duhet të përfitojë paditësi sipas Kodit të Punës, ndërkohë që ai nuk i kërkon ato.

32. Duke shqyrtuar përmbajtjen e vendimeve gjyqësore në raport me rrethanat e çështjes, Gjukata konstaton se pavarësisht se urdhri i lirimit nuk është i bazuar në Kodin e Punës, por në dispozitat e ligjit për statusin e nëpunësit civil, gjykata e apelit dhe Gjukata e Lartë nuk e kanë analizuar këtë rrethanë. Konkretisht edhe pse kërkuesja ka pretenduar paligjshmërinë e lirimit nga detyra/ndërprerjes së marrëdhënies së shërbimit civil dhe zgjidhjen e pasojave të kësaj paligjshmërie, përmes rikthimit në detyrë dhe pagimit të pagës për kohën e qëndrimit pa punë, gjykata e apelit e ka pranuar paligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, duke mos e konsideruar atë si marrëdhënie shërbimi civil, por sipas Kodit të Punës. Ajo ka zgjidhur pasojat e kësaj paligjshmërie përmes akordimit të dëmshpërblimit të disa pagave, si dhe duke rrëzuar kërkimin për rikthimin në punë. Ndërkohë, Gjukata e Lartë ka arritur në përfundimin se, me të drejtë, gjykata e apelit ka vlerësuar se marrëdhënia në rastin konkret nuk është marrëdhënie shërbimi civil dhe, nisur vetëm nga ky fakt, ka konsideruar të pabazuar pretendimin për paligjshmërinë e lirimit nga detyra të kërkueses, pa e shqyrtuar në themel nëse lirimi nga detyra, pra nëse ndërprerja e marrëdhënies së punës, ka qenë apo jo në përputhje me ligjin, qoftë edhe me ligjin e identifikuar prej saj si ligji i zbatueshëm. Po kështu, Gjukata e Lartë ka evidentuar se nuk ka kërkime në padi për zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë së lirimit nga detyra referuar ligjit të zbatueshëm, që është Kodi i Punës, dhe në këtë kuptim, gjykata e apelit ka gabuar kur është shprehur në këtë drejtim.

33. Nën këtë analizë, Gjukata vlerëson se pretendimi thelbësor i kërkueses për paligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të zgjidhjes së pasojave të tij, nuk ka marrë përgjigje nga Gjukata e Lartë qoftë edhe sipas ligjit të identifikuar si të zbatueshëm prej saj. Referuar këtij arsyetimi, Gjukata çmon se Gjukata e Lartë ka mbajtur qëndrim formalist, duke mos shkuar përtej ligjit për të synuar të drejtën. Në rastin kur individ i kundërshton paligjshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, gjykatat e zakonshme nuk mund të kufizohen vetëm në konstatimin nëse zgjidhja është e rregullt ose jo, por ato kanë detyrimin të shprehen edhe për

pasojat e paligjshmërisë, qëndrim ky që është konfirmuar edhe nga vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 19, datë 15.11.2007.

34. Për sa më sipër, Gjykata çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të tregohen formaliste, duke lënë pa përgjigje pretendime thelbësore nisur thjesht dhe vetëm nga fakti se paditësit nuk kanë identifikuar saktë bazën ligjore ku mbështesin pretendimet e tyre, pasi është detyrë e gjykatës të kualifikojë vetë mosmarrëveshjen në përputhje me parimin *iuria novit curia*, i cili në procesin gjyqësor administrativ dhe atë civil gjen shprehje në nenin 6 të KPC-së. Për më tepër, referuar edhe vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë, gjykatat e zakonshme nuk janë të lidhura nga kualifikimi juridik që palët i bëjnë mosmarrëveshjes, pasi mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë, ndaj dhe është detyrë e gjykatës që të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë. Thënë këtë, Gjykata vëren se e drejta që është pretenduar nga kërkuesja në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përbën shkakun juridik të padisë, pra thelbin e kërimit. Me fjalë të tjera, në thelb të padisë së kërkueses, pavarësisht bazës ligjore të përdorur, ka qenë ndërprerja pa shkak të ligjshëm e marrëdhënies së shërbimit civil (lloj i marrëdhënieve të punës) dhe rregullimi i pasojave që rrjedhin prej saj, çështje për të cilën nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë.

35. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, e cila shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Nisur nga sa më lart, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, nuk mund të mbante qëndrim të shprehur vetëm për paligjshmërinë e aktit me të cilin është ndërprerë marrëdhënia e punës, referuar ligjit të identifikuar prej saj, pa u shprehur për pasojat e kësaj paligjshmërie. Një qëndrim i tillë jo vetëm është formalist, por edhe arbitrar, në kuptim të gabimeve të dukshme, nga pikëpamja ligjore. Po kështu, rrëzimi i kërkesëpadisë me arsyetimin, në thelb, se ligji i zbatueshëm është i ndryshëm nga ai i pretenduar nga pala, pa e zgjidhur çështjen në themel, vë në dyshim edhe aksesin substancial të kërkueses, duke ia bërë të pamundur asaj një kërkim tjetër të ri, qoftë edhe nëpërmjet një padie të re me bazë ligjore sipas trajtimit të Gjykatës

së Lartë. Në këtë mënyrë, duke mos marrë përgjigje për themelin e pretendimeve të saj, kërkueses i është cenuar edhe thelbi i së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, të garantuar në mënyrë të shprehur nga neni 49 i Kushtetutës, pa një proces të rregullt ligjor.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të aksesit substancial dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses duhet të pranohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri.

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit 00-2024-2102(205), datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.02.2026

Shpallur më 12.03.2026